

VENDIM
Nr. 70, datë 12.3.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 132,
DATË 6.12.2011, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s DHE TRANSFERUAR ME
VENDIMIN NR. 126, DATË 28.10.2013, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s, TË
SHOQËRIA “KURUM INTERNATIONAL” SHA, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “ULËZ”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 24 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pika 3 dhe nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a” dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/5 prot., datë 11.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a.,

konstatoi se:

-Shoqëria “Kurum International” sh.a., me shkresën nr. 427 prot., datë 5.3.2021, ka përcjellë në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC “Ulëz”.

-Kërkesa për modifikim, vjen për arsye se gjatë rehabilitimit të këtij HEC-i, në lidhje me optimizimin e operimit të turbinave, janë zëvendësuar me pajisje te reja disa pajisje kryesore të HEC-it, çka ka sjellë edhe rritjen e kapacitetit të tij me 6 mw.

-Licencat e dhëna nga ERE me vendimin nr. 132/2011, “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Ulëz – Shkopet’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ulëz” dhe “Shkopet”, dhe me vendimin nr. 136/2011, “Për licencimin e shoqërisë ‘HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2’ sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC ‘Bistrica 1 dhe Bistrica 2’”, janë transferuar te shoqëria “Kurum International” sh.a. me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 126, datë 28.10.2013, me nr. 213, seria PM13P.

-Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Kurum International” sh.a., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton i plotësuar si më poshtë:

Në zbatim të nenit 7, “Delegimi i të drejtave të aplikuesit”, pika 2, germa “a”, do t’i kërkohej shoqërisë “Kurum International” sh.a., të depozitojë në ERE autorizimin për përfaqësuesin ligjor të saj.

Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

- Neni 9, pika 1, germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (të dhëna për aplikuesin). Plotësuar;

- Neni 15, pika 4:

- germa “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës. Plotësuar;

- germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Nuk aplikohet për këtë rast, pasi HEC “Ulëz” është HEC privat;

- germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE. Plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 15, pika 4:

- germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës. Pa plotësuar;

- germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi. Pa plotësuar, do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë ato brenda afateve që përcakton “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Po ashtu, në kuptim të nenit 11, pika 1, të “Rregullores së licencimit, shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a”, do t’i kërkohej edhe informacion rreth vlefshmërisë së “Marrëveshjes për lidhje të re”, që ka nënshkruar me OST sh.a., në kuadër të ndryshimeve të karakteristikave të HEC, të cilat prekin kapacitetin total të instaluar dhe vlefshmërinë e lejes mjedisore që disponon.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës me nr. 213, seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të shoqëria “Kurum International” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Ulëz” me kapacitet të instaluar 24 mw, si më poshtë:

Ishte: kapaciteti i instaluar 24 MW.

Bëhet: kapaciteti i instaluar 31 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti